18. Fryma e Re Demokratike;
19. Partia Balli Kombëtar;
20. Partia Republikane Shqiptare;
21. Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet;
22. Partia Ora e Shqipërisë;
23. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar;
24. Partia Socialiste e Moderuar;
25. Partia Agrare Ambjentaliste;
26. Partia Qytetare Shqiptare;
27. Balli Kombëtar Demokrat;
28. Partia Kombëtare Konservatore Albania;
29. Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
30. Lëvizja për Zhvillim Kombëtar;
31. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
32. Partia Aleanca Popullore;
33. Partia Ardhmëria Shqiptare;
34. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve të Shqipërisë;
35. Partia e Gjelbër;
36. Partia Emigracioni Shqiptar;
37. Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet;
38. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim European;
39. Lëvizja e Re;
40. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;
41. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim;
42. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë;
43. Partia Bindja Demokratike;
44. Partia Lëvizja për Ndryshim;

45. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;

46. Nisma Thurje.

## **II.2 Raportet financiare të dorëzuara jo në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore**

Nga shqyrtimi i raporteve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se 86 (tetëdhjetë e gjashtë) parti politike nuk kanë dorëzuar raport financiar vjetor për vitin 2021, si më poshtë vijon:

1. Partia Punës Shqipërisë;
2. Partia Aleanca Demokracia e Re;
3. Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;
4. Partia e Blertë Shqiptare;
5. Partia Uniteti Kombëtar;
6. Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;
7. Partia Universale Shqiptare;
8. Partia Liberale Shqiptare;
9. Partia Ekologjike;
10. Partia Socialpunëtore e Shqipërisë;
11. Partia Socialreformiste e Shqipërisë;
12. Partia Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare;
13. Lëvizja Demokratike për Vlera, Mirëqenie, Progres;
14. Partia Alternative Republikane;
15. Partia Konservatore;
16. Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar;
17. Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare;
18. Partia Triumfi i Legalitetit;
19. Partia Rimëkëmbja Kombëtare;
20. Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare;
21. Partia Pajtimit Kombëtar;
22. Partia Komuniste e Shqipërisë (e rindërtuar);
23. Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare;
24. Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë;
25. Partia Komuniste e Shqipërisë;
26. Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare;
27. Partia Ambientaliste;
28. Partia Aleanca Nacionale Shqiptare;
29. Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare;



30. Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare;
31. Partia Demokrate e Re;
32. Partia Mendimi i Djathtë Liberal;
33. Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë;
34. Partia Aleanca Socialiste Shqiptare;
35. Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptare;
36. Partia Shpresa Demokrate;
37. Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori;
38. Partia Demokratike Peza Gjirokastër e Shqipërisë;
39. Partia Integritimit Social Kombëtar Shqiptar;
40. Partia Lidhja e Blertë Shqiptare;
41. Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut;
42. Partia Shqiptare Atdheu;
43. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
44. Partia e të Drejtave të Mohuara;
45. Partia e Çështjeve Shqiptare;
46. Partia Fronti i Majtë;
47. Partia Shqipëria e Re;
48. Partia Lëvizja Elitare Kombëtare;
49. Partia Shqiptare e Rindërtimit;
50. Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare;
51. Partia e të Drejtave të Mohuara – e Re;
52. Lista për Shqipëri Natyrale;
53. Partia Aleanca Kombëtare;
54. Partia Progresi Social Kombëtar;
55. Partia Aleanca për Europën;
56. Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë;
57. Partia “Ligj dhe Drejtësi”;
58. Partia Socialiste e Vërtetë 91;
59. Partia G99;
60. Partia Toleranca e Re e Shqipërisë;
61. Partia Aleanca Europiane Ekologjike;
62. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
63. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve;

64. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;
65. Partia Lëvizja Shqipëria e Re;
66. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi e Shqipëtarëve;
67. Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres;
68. Partia "Aleanca Kuq e Zi";
69. Partia "Forca Rinia";
70. Partia "Shkodra 2015";
71. Partia "Sfida për Shqipërinë";
72. Partia "Lëvizja Demokratike Shqiptare";
73. Partia Independentëve ( Centriste) të Shqipërisë;
74. Partia Nacional Demokrate e Shqipërisë;
75. Partia Lidhja Popullore Shqiptare;
76. Partia Nacionaliste Shqiptare;
77. Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë;
78. Partia Drejtësia Shoqërore;
79. Partia Progresi Demokratik;
80. Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare;
81. Partia e Re Socialiste e Shqipërisë;
82. Partia Ideali Demokratik Shqiptar;
83. Partia Lëvizja për Demokraci;
84. Partia Ideali komunist;
85. Partia e Biznesit Shqiptar;
86. Aleanca Popullore për Drejtësi.

Referuar nenit 23/4, pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, "Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë".

### **III. Auditimi i raporteve financiare**

Neni 23/2, i ligjit "Për partitë politike", parashikon detyrimin e KQZ për të përzgjedhur ekspert kontabël të licensuar për të audituar fondet e përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021.

KQZ më datë 2.3.2022 shpalli në faqen zyrtare të internetit njoftimin për të aplikuar si ekspert kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të vitit kalendarik 2021.

KQZ më datë 22.4.2022 hodhi shortin online për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021.

KQZ me vendimin nr. 150, datë 26.4.2022, "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2021", caktoi 4 ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u dorëzuan 132 (njëqind e tridhjetë e dy) raporte auditimi nga audituesit ligjor, nga të cilët:

- 11 (njëmbëdhjetë) parti politike janë audituar dhe raporti i auditimit është certifikuar pa rezervë,
- 10 (dhjetë) parti politike janë audituar dhe raporti i auditimit është certifikuar me opinion me rezervë,
- 80 (tetëdhjetë) parti politike nuk janë audituar për shkak të adresave jo të sakta,
- 14 (katërmëdhjetë) parti politike nuk janë audituar pasi kanë paraqitur pasqyra financiare me vlerë 0,
- 2 (dy) parti politike i kanë deklaruar ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) se nuk kanë pasur asnjë të ardhur apo shpenzim për vitin kalendarik;
- 13 (trembëdhjetë) parti politike nuk kanë bashkëpunuar me ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor);
- 1 (një) parti politike nuk është audituar për shkak se nuk ka likuiduar ekspertin kontabël të licensuar (audituesin ligjor) të viti paraardhës;
- 1 (një) parti politike nuk është audituar pasi është shpallur në listën e subjekteve me statusin pasiv nga organet tatimore.

Nga audituesit u shprehën opinione me rezervë për:

1. "Partinë Socialiste të Shqipërisë", e audituar nga zj. Silvana Gjikhima, e cila ka konstatuar se partia nuk ka pasqyruar në raportin e saj vjetor, si në të ardhurat dhe në shpenzimet, donacionet në natyrë për qiranë e zyrave të fushatës zgjedhore, ndërkohë që tek raporti i fushatës zgjedhore i ka përfshirë si në të ardhura dhe në shpenzime me të njëjtën vlerë. Gjithashtu nuk janë përfshirë në raportin vjetor të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, ndërkohë që në raportin e fushatës zgjedhore janë të përfshira. Referuar nenit 23/4 pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar "Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë".
2. "Partinë Demokratike", e audituar nga audituesja zj. Meri Lika, e cila ka konstatuar se formati i raportimit financiar i partisë politike nuk është në përputhje me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", nenin 23, pika 3, ku përcaktohet se "Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare", si dhe nga ana e partisë nuk është bërë i mundur aksesimi për të kontrolluar veprimet kontabël, por gjithçka u mjaftua vetëm me

dorëzimin e faturave dhe statement bankare. Duke qenë se partia në KQZ e ka dorëzuar raportin me të dyja firmat u rikontaktua audituesja ligjore, e cila mori në dorëzim raportin e rregullt të partisë dhe kontaktoj përsëri me financierin e kësaj partie. Pas komunikimit me financierin e partisë audituesja dorëzoi në KQZ raportin e ri të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga PD ku sqaron se përsëri nga ana e partisë nuk i është bërë i mundur aksesimi për të kontrolluar veprimet kontabël, por gjithshka u mjaftua vetëm me dorëzimin e faturave dhe statement bankar. Referuar nenit 23/4, pika 2 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar “Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licensuar, të caktuar nga KQZ, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë”.

3. “Partinë Ardhmëria Shqiptare”, e audituar nga audituesja zj. Meri Lika, e cila ka raportuar se formati i raportimit të partisë politike nuk është në përputhje me ligjin nr. 25/201, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, specifikisht me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave jo Fitimprurëse seksioni 25, sepse mungojnë pasqyrat e pozicionit financiar dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.
4. “Partinë Aleanca Demokratike Shqiptare”, e audituar nga audituesja zj. Meri Lika, e cila ka raportuar se formati i raportimit të partisë politike nuk është në përputhje me ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, specifikisht me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave jo Fitimprurëse seksioni 25, sepse mungojnë pasqyrat e pozicionit financiar dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare.
5. Partinë “Lëvizja për Ndryshim”, e audituar nga zj. Silvana Gjokdhima, e cila ka konstatuar se tek raporti financiar partia politike nuk ka paraqitur të ardhura dhe shpenzime për degët e saj. Tek të ardhurat nuk janë pasqyruar donacionet në natyrë për qiranë e zyrave në masën 35,000 leke, si dhe donacionet në para në vlerën 116,096 lekë të kryera në rrjetet sociale (facebook). Sipas opinionit të auditueses vlerat e mësipërme nuk janë përfshirë në shpenzimet vjetore të partisë politike. Referuar raportit të auditimit të fushatës zgjedhore 2021, audituesja ligjore zj. Eneida Rahmani, e cila ka kryer auditimit e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partia Lëvizja për Ndryshim ka shprehur opinion pa rezervë si dhe është raportuar vlera 35.000 lekë për zyrat në përdorim nga partia dhe vlera 116.096 lekë pagesë e kryer nga zj. Jozefina Topalli për Facebook.
6. “Partinë Socialdemokrate”, e audituar nga audituesja zj. Silvana Gjokdhima, e cila ka konstatuar se partia ka përgatitur pasqyra financiare jo sipas standardit të kontabilitetit për organizatat jo fitimprurëse, por pasqyra të thjeshta, si dhe një pjesë e shpenzimeve të kryera nga partia kanë dokumenta mbështetëse vetëm kuponin tatimor dhe jo faturë të rregullt tatimore.
7. Partinë “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, e audituar nga zj. Silvana Gjokdhima, e cila ka konstatuar se partia për një pjesë të shpenzimeve të saj të kryera gjatë fushatës zgjedhore nuk ka dokumenta justifikues. Gjithashtu tek pasqyrat financiare të vitit 2021 nuk janë paraqitur pasqyrat e flukseve të mjeteve monetare, shpjegimet sqaruese, si dhe politikat kontabël të ndjekura nga subjekti, tek të ardhurat e vitit nga dhurimet e bëra është përfshirë një shumë 300,000 lekë, por nuk ka dokument për donacione. Kjo shumë është dhënë donacion nga Partia Demokratike, me të cilën kanë qenë në koalicion në vitet e mëparshme. Referuar raportit të auditimit të fushatës zgjedhore 2021, audituesi ligjor, z. Erjon Saraçi, i cili ka kryer

auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia për fushatën zgjedhore ka shprehur opinion me rezerve duke sqaruar se subjekti zgjedhor “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” ka kryer shpenzime për fushatën zgjedhore pa dokumentacion justifikues në shumën 325,000 lekë, prej te cilave 150,000 lekë kanë qenë të pa-paguara. Referuar nenit 23/4 pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar “Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë”.

8. “Partinë Socialiste të Moderuar”, e audituar nga zj. Fatmira Kastrati, e cila ka konstatuar se:
  - pasqyra e pozicionit financiar të partisë nuk paraqet drejt vlerat e detyrimeve dhe vlerën e aktiveve neto me datë 31.12.2021;
  - pasqyra e performancës financiare nuk përmban llogaritjen e amortizimit të AMM-ve, sipas kërkesave të Standartit Kombëtar të Kontabilitetit;
  - pasqyra e shënimeve shpjeguese nuk është hartuar sipas kërkesave të kuadrit të përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të SKK-së.
9. Partinë “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen”, e audituar nga zj. Fatmira Kastrati, e cila ka konstatuar se:
  - pasqyrat financiare nuk janë paraqitur sipas kërkesave ligjore të SKK-së për OJF-të. Si rrjedhojë e paraqitjeve jo të drejta të posteve të pasqyrave financiare, Partia nuk paraqet gjendjen e aktiveve neto të saj;
  - mungon pasqyra e likuiditeteve;
  - nuk është paraqitur as si e ardhur në natyrë dhe as si shpenzim indirekt për periudhën 26.08.2021-31.12.2021 vlera e ambientit të zyrës që MEGA ka marrë në huapërdorje nga bashkia e Sarandës, sipas kontratës së datës 26.8.2021;
  - Partia MEGA nuk jep informacion për përdorimin e zyrës për periudhën 01.01.2021-26.08.2021 nëse ka pasur këtë ambient apo ndonjë tjetër dhe kushtet e përdorimit të saj;
  - pasqyra e shënimeve shpjeguese të saj nuk jep informacionet e duhura dhe nuk është në zbatim të Udhëzimit për zbatim për OJF-të, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të Shtatorit 2018;
  - mungon edhe informacion në lidhje me sigurinë e vazhdimësisë së Partisë, sipas Udhëzimit për zbatim për OJF-të të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të Qershorit 2020.

Referuar nenit 23/4 pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar “Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë”.

10. Partinë “Fryma e Re Demokratike”, e audituar nga zj. Fatmira Kastrati, e cila konstaton se:
  - pasqyra e performancës financiare ose e aktiviteteve nuk paraqet drejt ndarjet e aktiviteteve të partisë “Fryma e re Demokratike” për vitin 2021, si edhe vlerat

përkatëse për disa zëra të shpenzimeve të raportuara;

- pasqyra e likuiditeteve nuk është hartuar sipas kërkesave të kuadrit të përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të SKK-së nr. 1 dhe SKK-së për OJF-të;
- pasqyra e shënimeve shpjeguese nuk është hartuar sipas kërkesave të kuadrit të përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të SKK-së nr. 1, SKK-së për OJF-të dhe Udhëzimit për zbatim për OJF-të, të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të Shtatorit 2018.

Nga audituesit ligjorë nuk janë audituar 80 (tetëdhjetë) parti politike pasi i është dërguar shkresë për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2021, por zarfi është kthyer nga posta për arsye të adresave jo të sakta të partitë politike:

1. Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar;
2. Parti Rruga e Vërtetë Shqiptare;
3. Partia Indipendentëve (Centriste) të Shqipërisë;
4. Partia Pajtimi Kombëtar;
5. Partia e Blertë Shqiptare;
6. Partia e Biznesit Shqiptar;
7. Partia e Punës Shqipërisë;
8. Partia Lëvizja Monarkiste Demokrate Shqiptare;
9. Partia Fronti i Majtë;
10. Partia Mbrojtja e të Drejtave Kombëtare;
11. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare;
12. Partia Përparimi Kombëtar i Shqipërisë;
13. Lista për Shqipëri Natyrale;
14. Partia Socialpunëtore e Shqipërisë;
15. Partia Mendimi i Djathtë Liberal;
16. Partia Nacional Demokrate e Shqipërisë;
17. Partia Alternativa Liberale e Shqipërisë;
18. Partia Lëvizja për të Drejtat e Njeriut;
19. Partia e të Majtës Demokratike Shqiptare;
20. Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres;
21. Partia Lëvizja Elitare Kombëtare;
22. Partia Demokratike Peza Gjirokastër e Shqipërisë;
23. Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane;
24. Partia e Djathtë Demokratike e Shqipërisë;
25. Partia Lëvizja Shqipëria e Re;
26. Aleanca Popullore për Drejtësi;
27. Partia Shqipëria e Re;

28. Partia Centriste Mirëqenies Popullore Shqiptare;
29. Partia Triumfi i Legalitetit;
30. Partia e Prosperitetit Demokratik të Shqipërisë;
31. Partia Lidhja Popullore Shqiptare;
32. Partia Konservatore;
33. Lëvizja Demokratike për Vlera, Mirëqenie e Progres;
34. Partia Lëvizja për Demokraci;
35. Partia Lista e Barabartë;
36. Partia Aleanca Demokracia e Re;
37. Partia e të Drejtave të Mohuara;
38. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorve të Shqipërisë;
39. Partia Komuniste e Shqipërisë 8 Nëntori;
40. Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë;
41. Partia Progresi Demokratik;
42. Partia Aleanca Socialiste e Shqipërisë;
43. Partia Lidhja e Blertë Shqiptare;
44. Partia Demokracia Paqësore e Shqipërisë;
45. Partia Progresi Social Kombëtar;
46. Partia Kombëtare Konservatore Albania;
47. Partia Ekologjike;
48. Partia Shpresa Demokrate;
49. Partia Aleanca Nacionale Shqiptare;
50. Partia Demokracia e Re e Djathtë Shqiptare;
51. Partia Beslidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare;
52. Partia Demokratike e Bashkimit Myslyman të Shqipërisë;
53. Partia e Re Socialiste e Shqipërisë;
54. Partia Lëvizja e Legalitetit;
55. Partia Rimëkëmbja Kombëtare;
56. Partia Lidhja Kombëtare Shqiptare;
57. Partia Liberale Shqiptare;
58. Partia Drejtësia Shoqërore;
59. Partia Shqiptare e Rindërtimit;
60. Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare;
61. Partia Forca Rinia;
62. Partia Socialreformiste e Shqipërisë;
63. Partia Uniteti Kombëtar;
64. Partia Ambientaliste;



65. Partia Bashkësia Kombëtare Shqiptare;
66. Partia Alternative Republikane;
67. Partia Qytetare Shqiptare;
68. Partia Toleranca e Re e Shqipërisë;
69. Balli Kombëtar Demokrat;
70. Partia e Çështjeve Shqiptare;
71. Partia Nacionaliste Shqiptare;
72. Partia Ideali Komunist;
73. Partia Demokrate e Re;
74. Partia Sfida për Shqipërinë;
75. Partia Komuniste Shqiptare (e Rindërtuar);
76. Partia Personat me Aftësi të Kufizuar;
77. Partia Aleanca për Europën;
78. Partia Ideali Demokratik Shqiptar;
79. Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare;
80. Partia Universale Shqiptare.

Nga audituesit ligjorë nuk është kryer auditimi për 14 (katërmbëdhjetë) parti politike pasi partitë politike kanë paraqitur në KQZ pasqyrat financiare me vlerë 0, si konkluzion për shkak se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë auditim nuk mund të shprehet një opinion lidhur me procesin e auditimit nga audituesit ligjor:

1. Partia Lëvizja Demokratike për Ndryshim;
2. Partia Lëvizja për Drejtësi e Shqiptarëve;
3. Partia Socialiste e Vërtetë 91;
4. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve;
5. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë;
6. Partia Ora e Shqipërisë;
7. Partia Emigracioni Shqiptar;
8. Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar;
9. Partia Shqiptare Atdheu;
10. Partia Demokrate për Integrim e Prosperitet;
11. Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrim Europian;
12. Partia G 99;
13. Partia Reformave Demokratike Shqiptare;
14. Partia Demokracia Sociale.

Audituesi ligjor, z. Elton Tirana, për 2 (dy) parti politike, të cilat nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare

për vitin kalendarik 2021 në KQZ, ka marrë deklaratë nga kryetarët e partive politike, të cilët kanë deklaruar se nuk kanë pasur të ardhura dhe shpenzime si dhe nuk kanë përfituar fonde nga KQZ apo burime të tjera:

1. Partia Komuniste e Shqipërisë;
2. Partia Aleanca Kombëtare.

Audituesit u shprehën se nuk kanë pasur bashkëpunim me 13 (trembëdhjetë) parti politike, si më poshtë vijon:

1. Partia "Bindja Demokratike" me audituesen ligjore pasi partia nuk i ka dorëzuar auditueses dokumentacionin e kërkuar nga kjo e fundit për të kryer auditimin, duke u justifikuar se dokumentacionin që kërkonte mund ta gjente në protokollin e KQZ-së.
2. Partia Zgjidhja, pasi edhe pse audituesja ka kontaktuar nëpërmjet telefonit me kryetarin dhe me financiarin e partisë nuk i janë dhënë informacionet e kërkuara nga këto të fundit.
3. Partia Balli Kombëtar, pasi audituesja ka kontaktuar me kryetarin e partisë, i cili i ka dhënë numrin e ekonomistit, nuk i është dhënë asnjë informacion lidhur me raportin financiar vjetor që partia ka dorëzuar në KQZ. Pas disa komunikimeve nëpërmjet telefonit dhe email-it me financiarin, i cili për arsye shëndetësore nuk e ka pasur të mundur takimin me audituesen, i është kthyer përgjigje se partia nuk mund ta paguaj për punën që audituesja po kryen.
4. Partia Kristian Demokrate, pasi audituesja ka kontaktuar me kryetarin e partisë nuk i është dhënë asnjë informacion mbi raportin financiar të partisë për vitin 2021 që është dorëzuar në KQZ. Gjithashtu sipas komunikimit me kryetarin e partisë, z. Dhimitër Muslia, ai kërkoi që audituesja të mos e shqetësonte më për këtë problem.
5. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, pasi audituesi ligjor ka kontaktuar me partinë politike nuk është dhënë asnjë dokumentacion tjetër vërtetues mbi bazën e të cilit janë përgatitur pasqyrat financiare të partisë politike. Gjithashtu vetë partia politike ka informuar se nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
6. Partia Integrimi Social Kombëtar Shqiptar, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
7. Partia Sigurisë Kombëtare Shqiptar, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
8. Partia e të Drejtave të Mohuara - e Re, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
9. Partia Ligj dhe Drejtësi, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
10. Partia Aleanca Popullore, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të

auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.

11. Partia Aleanca Kuq e Zi, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
12. Partia Shkodra 2015, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.
13. Partia Aleanca Europiane Ekologjike, pasi audituesi ligjor i ka dërguar njoftim për fillimin e procesit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partia nga kjo e fundit është marrë njoftimi por nuk kanë kontaktuar me audituesin ligjor.

Referuar nenit 23/4, pika 2 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, "Shkelja e detyrimit për bashkëpunim me ekspertin kontabël të licensuar, të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nga ana e partisë politike, dënohet me gjobë nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë.

Për partinë "Lëvizja Puntore Shqiptare", audituesja ligjore nuk ka kryer auditimin për shkak se partia nuk ka likuiduar ekspertin kontabël të licensuar të vitit paraardhës duke iu referuar Kodit të Etikës për Ekspertët Kontabël të Regjistruar, pika 21.4.3 ... *"Para se të hyjë në funksion, për kryerjen e një angazhimi të auditimit të pasqyrave financiare, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ketë marrë nga klienti një dokument që përlligj pagimin nga klienti të honorarëve për paraardhësit të tij, kur ato janë bazuar në një marrëveshje qartësisht të përcaktuar, ose kur i përgjigjen tabelës së hartuar nga instituti për punimet e kryera dhe kur zbatimi i këtyre punimeve nga paraardhësit nuk ka qenë kundërshtuar nga klienti".*

Referuar nenit 23/4 pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar "Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë".

Për partinë "Bashkimi Demokrat Shqiptar", audituesja ligjore është shprehur se partia është e shpallur në listën e subjekteve me statusin pasiv nga organet tatimore dhe bazuar në nenin 44, pika 7, e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, "Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridik, tregtarë që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet në përputhje me këtë ligj".

Referuar nenit 23/4 pika 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar "Shkelja e dispozitave për financimin e partive politike nga ana e personit përgjegjës për financat në partinë politike apo e personit përgjegjës sipas statutit të saj dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë".

#### **IV. Shqyrtimi i raporteve financiare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të dorëzuara nga partitë politike dhe ekspertët kontabël të licensuar**

Nga raportet e auditimit të ekspertëve kontabël të licensuar dhe verifikimet e bëra nga Komisioni

Qendror i Zgjedhjeve u konstatua se partitë politike nuk kanë pasur detyrimin të dorëzojnë raportet financiare vjetore sipas kërkesave ligjore të SKK-së për OJF-të.

Përsa i përket “Partisë Lëvizja për Ndryshim” në raportin financiar të fushatës zgjedhore janë reflektuar sipas zërave përkatëse të gjitha shpenzimet e zyrave si dhe të mediave sociale.

Për partinë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” audituesi është shprehur me opinion me rezervë mbi mosdeklarimin e dhurimeve në natyrë për qiranë e zyrave të fushatës zgjedhore te datës 25 Prill 2021, ndërkohë këto zyra rezultojnë te deklaruar në raportin e fushatës zgjedhore.

Kryefinancierja e partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë” pasi u njoh me problematikën e shprehur nga audituesi nëpërmjet emailit ka depozituar në KQZ relacion shpjegues. Kryefinancierja thekson se kur është mbyllur bilanci i vitit 2021 nuk është ngarkuar me Shpenzimet dhe të Ardhurat e fushatës për Kandidatët por e kanë cilësuar në Materialin Shpjegues të Bilancit të Ardhurat dhe Shpenzimet e tyre. Gjithashtu për zyrat elektorale me hua përdorje të fushatës duke menduar se janë dhurim në natyrë e kanë deklaruar vetëm në Raportimin e Raportit të Zgjedhjeve të 2021 .

Për sa i takon këtij konstatimi audituesja e ka lënë detyrë dhe në bilancin e vitit 2022, është integruar edhe fushata zgjedhore e datës 6 Mars.